REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Nr. 302/4 Prot.

Fier, më 07.02.2024

Lënda:Mbi zbatimin e udhëzimit nr.2 datë 08.02.2023 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikim".

DREJTORIVE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Fier

Bazuar në Ligjin 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",Udhëzimit nr.2 datë 08.02.2023 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit",vendimit nr.99,datë27.02.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin ,mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë të Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", "Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore",ju informojmë si më poshtë:

1.Mësuesit të cilët i nënshtrohen kualifikimit janë punonjësit e institucioneve arsimore parauniversitare publike dhe private, të cilët kanë diplomë në fushën e mësuesisë ose zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të pare dhe të dytë ose të barazvlefshme me to,të ngjashme ose të përaferta në fushën përkatëse të mësimdhënies në arsimin parauniversitar si dhe kandidatët që japin lëndët e muzikës,të arteve pamore,kërcimit dhe edukimit fizik.

2.Procedurave të kualifikimit u nënshtrohen detyrimisht të gjithë mësuesit të cilët deri në date 31.12.2023,plotësojnë:

- Të paktën 5 vjet punë për kategorinë e kualifikimit "Mësues i kualifikuar".
- Të paktën 10 vjet punë për kategorinë e kualifikimit "Mësues specialist".
- Të paktën 20 vjet punë për kategorinë e kualifikimit "Mësues mjeshtër".

3.Nëse konstatohen se ka punonjës arsimorë të përmendur në pikën 2 që kanë mospërputhje midis vjetërsisë së punës në arsim dhe kategorisë së kualifikimit,kualifikohen për kategorinë më të ulët që nuk e kanë fituar ende.

4.Drejtoritë e institucioneve arsimore të kryejnë verifikimin e dokumentacionit të çdo mësuesi lidhur me detyrimin e tyre për pjesëmarrjen në këtë proces dhe të informojnë punonjësit arsimor lidhur me përmbushjen e këtij detyrimi.Lista e mësuesve që kanë detyrimin për përfshirjen në kualifikim të përcillet në ZVAP Fier sipas modelit bashkëlidhur (Model 1).Në listë do të përfshihen edhe mësuesit që kanë detyrimin për kategorinë I (mësues mjeshtër).Lisat e përcjellë nga drejtorit e IA-ve është referuese lidhur me detyrimin e mësuesve për përfshirje në

këtë proces, por kriteret e kualifikimit dhe dokumentacioni do të rikontrollohet nga specialistët e ZVAP.

Nëse drejtorët e institucioneve arsimore kanë paqartësi lidhur me zbatimin e kritereve në këtë udhëzim të paraqiten në ZVAP për të marrë konsulencë.

Punonjësit arsimorë brenda datës 27 shkurt 2024,të dorëzojnë pranë ZVAP Fier portofolin personal dhe atë profesional sipas nenit 14 të këtij udhëzimi,ku të kenë bashkëlidhur:

Portofoli personal i kandidatit duhet të ketë këtë përmbajtje:
1.Jetëshkrimi (me fotografi).
2.Fotokopje e noterizuar e certifikatave me kreditet përkatëse (nëse ka).
3. Fotokopje e noterizuar e dëshmive të titujve /gradave shencore (nëse ka).
g) Fotkopje e noterizuar e dëshmive të,mbrojtjes së gjuhëve të huaja (nëse ka).

1.Fotokopjen e diplomës/ve +Listë notash (e noterizuar).
2. Fotokopjen e librezës së punës e noterizuar(vitet e punës në arsim) vërtetim nga e-albania për mësuesit që punojnë në institucion arsimor privat.
3.Vlerësimi i fundit i drejtorit të institucionit arsimor.
4.Formulari për aplikim (I plotësuar).

2. Portofoli professional i kandidatit duhet të ketë:
a)Plani i një aktiviteti të një klase të caktuar ose grup klasash ,organizuar nga kandidati përkatës,të realizuar gjatë vitit të kualifikimit ,të shoqëruara me realizimin e aktivitetit me foto.
1.Planifikim i një ore model (dhar)duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin sipas kurrikulës me kopetenca.
2.Testi/detyra përmbledhëse për një periudhë të caktuar ,sipas profilit përkatës, të realizuar gjatë vitit të kualifikimit, të shoqëruara me një analizë të thjeshtë të rezultateve të arritura në një klasë të caktuar.
g)Plani i një projekti kurrikular të zhvilluar nga nxënësit e një klase të caktuar,të shoqëruar me realizimin e tij me foto.

Dorëzimi I dokumentacionit do të b ëhet nëpërmjet shërbimit postar në adresën : Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier, rruga "Leon Rei",Fier.

6.Për punonjësit arsimor të cilët kanë detyrimin për përfshirjen në kategorinë I (mësues mjeshtër)duhen të përgatisin portofolin e zhvillimit profesional.Për mënyrën e realizimit të vlerësimit të kësaj kategorie mësuesish,ZVAP do t'ju informojë në vijim.

7. Drejtorit e institucioneve të marrin masa për njohjen e udhëzimit nga çdo punonjës arsimor duke e publikuar atë në faqen e institucionit arsimor dhe në këndin e njoftimeve të IA.

Në raste të konstatimeve të shkeljeve së detyrimeve ligjore që burojnë nga ky udhëzim ZVAP Fier do të marrë masa për trajnimin e tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTOR

Zaira Gjika

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

SHKOLLA ----------

Nr._____Prot. Fier, më ____.____.2024

Lënda:Dërgohet informacion për mësuesit të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim.

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Fier

Bazuar në Ligjin 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",Udhëzimit nr.2 datë 08.02.2023 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit",vendimit nr.99,datë27.02.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin ,mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë të Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar" "Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore",shkresës së ZVAP Fier me nr. ____,datë ____ ,ju informojmë se mësuesit të cilët kanë detyrime për përfshirjen në kategorinë e kualifikimit janë si më poshtë:

Nr.	Institucioni Arsimor	Emër/ Atësi / Mbiemër	Profili	Kategoria që do të përfitojë në 2024

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTOR